



ATE CONSULTING

AKT - THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"ATE CONSULTING ALBANIA" SHPK

Ortakët e Shoqërisë "ATE CONSULTING ALBANIA" SHPK, janë:

1. **Z. Erind Ruka**, i biri i Servet, shtetas Shqiptar, lindur më 08.07.1985 dhe banues në adresën: Largo Tirreno 115 CAP 10136 Torino, Itali, i identifikuar me numër pasaporte. I50708060B, person madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
2. **Z. Juan Manuel Penafiel Reyes**, i biri i Jose, shtetas Spanjoll, lindur më 20.02.1976 dhe banues në adresën: Via Migliarone 25/bis Alpignano, Itali, i identifikuar me ID nr. 20261046R, person madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

VENDOSËN

Neni 1

Të themelojnë një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar të quajtur:
"ATE CONSULTING ALBANIA" SHPK.

Shoqëria është një subjekt juridik shqiptar, të cilës i lind e drejta të ushtrojë aktivitetin që nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Shoqëria "ATE CONSULTING ALBANIA" SHPK zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me aktet e themelimit të saj.

Neni 2

Shoqëria do të jetë e formës së Shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar dhe përballon humbjet deri në kufirin e vlerës së derdhur në kapitalin themeltar.

Neni 3

"ATE CONSULTING ALBANIA" SHPK ka selinë e saj në adresën: Rruga "Panorama", mbrapa shkollës "Harry Fultz" 1016, Tiranë.

Shoqëria ka të drejtë të krijojë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, filiale, agjenci përfaqësimi, seli sekondare, degë, si dhe ti suprimojë ato.

Shoqëria ka gjithashtu të drejtë të krijojë, apo të jetë pjesë e një apo më shumë shoqërive tregtare, pavarësisht nga statusi i tyre juridik, me një pjesëmarrje që do të përcaktohet në çdo rast nga Asambleja e Ortakëve.



ATE CONSULTING

Neni 4

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë **pa afat**. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë në përputhje me dispozitat statutore dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 5

Kapitali fillestar themelor i Shoqërisë "ATE CONSULTING ALBANIA" SHPK do të jetë 100 lekë (njëqind) lekë, me kontributet e ortakëve si më poshtë:

Emri Mbiemri	Përqindja	Kuota	Kontributi në lekë
Z. Erind Ruka	50%	1	50 Lekë
Z. Juan Manuel Penafiel Reyes	50%	1	50 Lekë

Neni 6

Kapitali themeltar është tërësisht në para. Të gjitha kuotat e kapitalit themeltar janë tërësisht të derdhura dhe të nënshkruara nga ortaku themelues. Rritja e kapitalit të shoqërisë nuk është e kufizuar.

Neni 7

Objekti i shoqërisë përfshin ofrimin e shërbimeve të konsulencës në fusha të ndryshme si ajo dentare ,mjekësore, terapi ortopedi , kirurgji stomatologjike, kirurgji plastike dhe kirurgji të përgjithshme.

Konsulenca gjithashtu konsiston në:

- akomodim,
- shoqërim pacientesh,
- ndërmjetësim,
- hapje klinike dhe laboratorë dentare,
- hapje shkolle private e laboratorë dentare.

Import - Eksport i pajisjeve Dentare, si dhe i materialeve Dentare. Tregti me shumicë dhe pakicë të pajisjeve dhe produkteve Dentare dhe Materialeve Dentare, lëndë të para dhe material për industrinë stomatologjike, pajisje zyrash, kancelari, pjesë këmbimi, dhe makineri të çdo lloji, pajisje teknologjike etj. Shoqëria mundet gjithashtu të zhvillojë të gjitha veprimtaritë plotësuese, promovionale, marketingu, reklama që lidhen me sa më sipër, përfshirë këtu aktivitetet editoriale.

Neni 8

Shoqëria vepron nën regjimin e pronës private dhe merr përsipër të drejta e detyrime vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj. Ortakët themelues mbartin rrezikun e veprimtarisë së Shoqërisë në masën e kapitalit të investuar në Shoqëri.



ATE CONSULTING

Neni 9

Organet e shoqërisë "ATE CONSULTING ALBANIA" SHPK janë:

- Asambleja e Ortakëve të shoqërisë.
- Administratorët e shoqërisë.

Modalitetet e formimit dhe funksionimit të tyre do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

Administratorët e shoqërisë do të jetë **Z. Erind Ruka** dhe **Z. Juan Manuel Penafiel Reyes**, të cilët do të ushtrojnë dhe mbajnë bashkërisht në mënyrë të barabartë kompetencat e administratorit, për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh. Ky afat mund të ndryshojë lirisht në çdo moment që konsiderohet e nevojshme nga asambleja e ortakëve.

Përveç sa është përcaktuar shprehimisht në statutin dhe aktin e themelimit të shoqërisë, Administratorët do të kenë të dy tagra të kryejnë veprime bankare në llogarinë e shoqërisë që lidhen me tërheqjen e shumave të depozituara apo çdo veprim tjetër, veprime të cilat mund të kryhen vetëm nga administratorët apo çdo person të tjerë të autorizuar enkas me prokurë të posaçme për këtë qëllim.

Modalitetet për ndryshimin e administratorit si dhe kompetencat e tij rregullohen nga Statuti i shoqërisë, ligji 9901 datë 14.04.2008 " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" si dhe ligji Nr. 9723 datë 03.05.2007 " Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Ky Akt - Themelimi është përpiluar në katër kopje me vlerë të njëjtë me origjinalin.

ORTAKËT E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"ATE CONSULTING ALBANIA" SHPK

Z. Erind Ruka

Z. Juan Manuel Penafiel Reyes

ADMINISTRATORËT

Z. Erind Ruka

Z. Juan Manuel Penafiel Reyes,



ATE CONSULTING ALBANIA



ATE CONSULTING

Tiranë, më 03/05/2019